



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA TIRANË

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT  
(NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT)

OPERATORIT EKONOMIK “Ols Abazi” PF

**Adresa:** *Njesia Bashkiake Nr.5, Rruga "Margarita Tutulani", Ndertesa Nr.2, Tiranë*

Procedura e prokurimit/lotit: *E hapur e thjeshtuar;*

Numri i procedurës / referenca e Lotit: *REF-86699-11-07-2023;*

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: *“Realizimi i videove të shkurtra edukative dhe video-podcasteve për digjitalizimin”;*

Kohëzgjatja: *Data për fillimin e këtij projekti është menjëherë pas nënshkrimit të kontratës dhe kohëzgjatja e implementimit të detyrave do të jetë 7 (shtatë) muaj nisur nga kjo datë;*

Publikimet e mëparshme: *Buletini Nr. 93 datë 13 Nëntor 2023;*

Publikimet e mëparshme: *Buletini Nr. 100 datë 11 Dhjetor 2023;*

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të kësaj ju informojmë se Ofertuesit e mëposhtëm kanë marrë pjesë në këtë procedurë me këto vlera përkatëse të ofruara:

**1. OPERATORI EKONOMIK “Ols Abazi ” PF, me NIPT: L32307016C**

Çmimi total i ofertës pa TVSH = 5,400,000 (pesë milion e katërqind mijë) lekë.

**2. OPERATORI EKONOMIK “Regis Canameri” PF, me NIPT: L41329031Q**

Çmimi total i ofertës pa TVSH= 5,580,000 (pesë milion e pesëqind e tetëdhjetë mijë) lekë.

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

**1. OPERATORI EKONOMIK “Regis Canameri” PF, me NIPT: L41329031Q**

Çmimi total i ofertës pa TVSH= 5,580,000 (pesë milion e pesëqind e tetëdhjetë mijë) lekë.

Për arsyet e mëposhtme:

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të nenit 92 të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe nenit 82 pika 2 e VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar) si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga ky operator ekonomik, nga ku rezultoi si vijon:

**I. Autoriteti Kontraktor në pikën 2.3 /2.3.1 të rubrikës “Kapaciteti teknik” të DST, ka përcaktuar si më poshtë vijon :**

*“2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.*

*Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:*

*a) Si dëshmi për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.*

***b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.”***

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjatë shqyrtimit edhe vlerësimit të dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik “Regis Canameri PF” vëren se ky operator në funksion të kriterit si më sipër cituar, ka paraqitur kontratën nr .595633, të lidhur midis OE “Regis Canameri PF” dhe “OSCE”, si dhe kontratën e lidhur midis OE “Regis Canameri” PF, dhe “Shoqatës Save the Children Albania”(Kontrata të cilat nuk janë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe janë të panoterizuara duke rënë në kundërshtim me përcaktimin e bërë në shtojcën 8, “Kriteret e përgjithshme për kualifikim” ku është përcaktuar se “Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip”), por nuk kanë paraqitur faturat tatimore

të lëshuar për kontratat respektive duke rënë ndesh me përcaktimin e bërë në kriterin si më sipër cituar ku cilësohet se:

**“b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes...”, duke mos lënë asnjë opion apo alternativë tjetër për përmbushjen e këtij kriteri”.**

Në VKM nr. 285, datë 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar) neni 41, pika 3, mbi bazën e të cilit është ndërtuar edhe kriteri për kualifikim është përcaktuar se:

*“...Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara”.*

Pra sikundër është cilësuar edhe në VKM nr 285 dt 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), neni 41, pika 3, në rastin e përvojës së realizuar me sektorin privat i vetmi opion për përmbushjen e kriterit 2.3.1 është vetëm paraqitja e faturës tatimore te shitjes.

**Marrë shkas nga sa më sipër cituar, kriteri i përcaktuar në pikën 2.3.1 të “Kapacitetit Teknik”, NUK përmbushet nga OE “Regis Canameri” PF.**

## **II. Autoriteti Kontraktor në pikën 2 të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit të dokumentave standarde të tenderit, përcakton se:**

### **2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

*“2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:*

*Referuar pikës 1 të shtojcës 8, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9”.*

Në referencë të nenit 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, pika 2, shkronja g) e këtij neni, dhe sipas pikës gj) të shtojcës 8 të DST, AK përcakton “Ofertuesi deklaron se: ... gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi “;

Gjithashtu në Shtojcën 9 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit “të DST, seksioni “B: DEKLARATA “Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura””, pika 6, kërkohet specifikisht:

*“Ofertuesi deklaron se: (kliko një nga alternativat e mëposhtme):*

- a) Ofertuesi ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, pa komunikuar dhe pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër;

b) *Ofertuesi është konsultuar, ka komunikuar, ka bërë marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi deklaron se në dokumentet bashkangjitur, në detajet e kësaj oferte, janë përfshirë emrat e konkurrentëve, natyra dhe shkaqet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes apo angazhimit (rasti i bashkimit të operatorëve ekonomikë ose nënkontraktimit).*

□”.

Për sa më sipër, nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE nga Operatori Ekonomik **“Regis Canameri” PF**, dhe konkretisht nga verifikimi i *“Formularit përmbledhës të vetëdeklarimit”*, sipas Shtojcës 9, rezulton se:

OE **NUK** ka përzgjedhur një nga alternativat e kërkuara sipas pikës 6 të Seksionit *B DEKLARATA “Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura”*, duke mos deklaruar nëse ofertën e tij e *“...ka përgatitur në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, pa komunikuar dhe pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër;”*, sipas pikës a), apo është në kushtet që *“Ofertuesi është konsultuar, ka komunikuar, ka bërë marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi...”* sipas pikës b).

Në këtë mënyrë pa u përcaktuar njëra nga alternativat si më sipërcituar AK nuk e merr informacionin e nevojshëm lidhur me këtë seksion të shtojcës 8.

KVO gjykon se në rastin konkret jemi në kushtet e mosplotësimit në formën e duhur të një shtojce e cila është pjesë përbërëse e dokumentave të procedurës së prokurimit dhe është e detyrueshme që të plotësohet sipas formatit të miratuar nga organet përgjegjëse.

Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

Sa më sipër, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 80 , nenit 92, pika 3, të Ligjit 162/2020, datë 23.12.2020, për *“Prokurimin Publik”*, dhe dhe në mbështetje të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”* Neni 79, neni 80, neni 82, **e shpall të pavlefshme** këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë, *Operatorin Ekonomik “Ols Abazi” PF*, me Adresë në *Njesia Bashkiake Nr.5, Rruga “Margarita Tutulani”, Ndertesa Nr.2,Tiranë*, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 5,400,000 (pesë milion e katërqind mijë) lekë pa tvsh, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë *Bashkisë Tiranë*, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se, nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj.

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit (Paraparak)

PO  JO

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë) \_\_\_\_\_

Ankesa pas Njoftimit të Anullimit të procedurës:

PO  JO

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë) \_\_\_\_\_